



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 24.5.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci, Mufera Shinik dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Munguan: Valentina Bunjaku – Rexhepi, Abdyl Salihu dhe Verica Çeraniq.

Përfaqësues të tjerë: Defrim Gashi-MASHT-i dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli dhe Rudina Fetahaj, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtim i Projektligjit nr. 06L/046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtim i Projektligjit numër 06L/046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;

Ismajl Kurteshi, fillon mbledhjen dhe ia dha fjalën përfaqësuesit të Ministrisë, Dëfrim Gashi për të paraqitur propozimet lidhur me çështjen e ankesave dhe sanksioneve kundërvajtëse me gjobë.

Dëfrim Gashi, propozoi që në nenin 4 të plotësohet paragrafi 3, me përfshirjen edhe të sektorëve të Inspektoratit të Arsimit, si në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Prizreni, Ferizaj dhe Mitrovicë, ndërsa mënyra e funksionimit rregullohet me akt nënligjor.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e dhënë nga përfaqësuesi i Ministrisë.

Dëfrim Gashi, në vijim ngriti çështjen e kriterëve bazë për punësim, që duhet të merren nga Ligji për Shërbimin Civil me specifikat që i parasheh ky ligj. Ai gjithashtu propozoi që tek neni 13, të ndryshohet titulli nga “vendimet e inspektorit në arsim” të kalojë në “vendimet e drejtorit të përgjithshëm, udhëheqësit e sektorit dhe të inspektorit”. Pra, të përfshihen edhe këto dy kategori meqë ligjërisht bartin të drejtën e nxjerrjes së vendimeve si dhe për çështje të ndryshme në procesin edukativo-arsimor.

Lidhur me nenin 16, që ka të bëjë me ankesat, tha se ankesat kundër vendimit të inspektorit të drejtohen tek drejtori i përgjithshëm i inspektoratit.

Nezir Çoçaj, tha se Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia është funksional që themelohet nga sekretari i përgjithshëm i MASHT-it, dhe nuk e sheh të arsyeshme të krijohet diçka që veçse ekziston dhe që merret me çfarëdo ankese. Ai tha se nuk mundet një person me mandat politik të krijojë komision. Së dyti, ai shtoi që, meqenëse Paneli i Artë ka të bëjë me punën e inspektorëve në vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, nuk duhet të ketë dorë ministri sepse është punë ekskluzive e drejtorit të përgjithshëm të inspektoratit. Ai u pajtua që inspektori i cili ka bërë vlerësimin e performancës së një mësimdhënësi, nuk mund të jetë pjesë e Panelit të Artë për atë mësimdhënës dhe prandaj janë kërkuar të jenë 3 anëtarë të fushës profesionale.

Arbërie Nagavci, tha se e konsideron të rëndësishëm adresimin e ankesave tek një komision i shkallës së dytë. Ajo tha që nëse një mësimdhënës është i pakënaqur me vendimin e inspektorit, ai ka të drejtë të paraqesë ankesën tek komisioni në shkallë të dytë për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave. Ajo tha që Komisionin e Ankesave e themelon sekretari për çështje të tjera ndërsa Komisioni i Ankesave, për të cilin po diskutohet ka të bëjë me shqyrtimin e ankesave kundër vendimit të inspektorit, andaj këtë Komision nuk duhet ta themelojë drejtori i përgjithshëm i inspektoratit por duhet ta themelojë ministri.

Nezir Çoçaj, tha është obligim i drejtorit të përgjithshëm të inspektoratit të japë përgjegjësi për punën që e bëjnë inspektorët e tij sepse nëse kjo përgjegjësi i kalon Ministrit, ai shqyrton ankesat e inspektorëve që nuk i njuh fare dhe që prapë do të e bartë këtë përgjegjësi tek drejtori i përgjithshëm i inspektoratit. Ai shtoi, që në aspektin e vlerësimit si shkallë e dytë, funksionon Paneli i Artë, ndërsa në aspektin administrativ, si shkallë e dytë funksionon Komisioni për Ankesa, i cili është funksional dhe që ministri nuk ka fare të bëjë me të.

Pas diskutimeve, lidhur me këto propozime, anëtarët e Komisionit u pajtuan që në mbledhjen e radhës të përcaktohen për cilin propozim do të vendoset.

3. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi